



**GREEN Solution**

Tirana, Albania. Tel: +355 69 83 90 970

**PËRMBLEDHJE JOTEKNIKE E RAPORTIT TË VLERËSIMIT TË NDIKIMIT  
NË MJEDIS**

**EMËRTIMI I PROJEKTIT:**

**NDËRTIM I PËRKOHSHËM IMPIANT PËR LARJEN E INERTEVE LUMORE.**

**VENDODHJA:**

**LUMI SHKUMBIN, PRANË FSHATIT KALUSH, NJËSIA ADMINISTRATIVE GOSË,  
BASHKIA RROGOZHINË, QARKU TIRANË.**

Sipas shtojces 1 te Ligjit Nr. 10448, date 14.07.2011 "Per lejet e mjedisit", i ndryshuar, pika  
3.10 "Prodhimi i produkteve abrazive dhe produkteve të tjera minerale jometalike",  
Te gjitha instalimet Leje Mjedisi tipi B.

**Kërkues:**

**Subjekti "FADIL DULLA" Person Fizik**

**NIPT: K72910812I**

Ky raport i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis u hartua nga Studio:  
**"GREEN Solution"**

Laert Shehu

Ekspert Mjedisi



Vanina Latifi

Eksperte Mjedisi

Mars, 2017

**TABELA:**

**STRUKTURA E RENDITJES DHE INFORMACIONIT QË PËRMBAN KY RAPORT I VNM**

**Hyrje**

<b>1. INFORMACION PËR QËLLIMIN E VNM DHE METODIKËN E ZBATUAR.....</b>	<b>4</b>
<b>2. PËRSHKRIMI I MBULESËS BIMORE TË SIPËRFAQES KU PROPOZOHET TË ZBATOHE PROJEKTI.....</b>	<b>5</b>
<b>3. INFORMACION PËR PRANINË E BURIMEVE UJORE NË SIPËRFAQEN E KËRKUAR NGA PROJEKTI DHE NË AFËRSI TË SAJ. ....</b>	<b>11</b>
<b>4. IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE TË MUNDSHME NEGATIVE NË MJEDIS.....</b>	<b>25</b>
<b>5. PËRSHKRIM I SHKARKIMEVE TË MUNDSHME NË MJEDIS.....</b>	<b>28</b>
<b>6. INFORMACIONI PËR KOHËZGJATJEN E MUNDSHME TË NDIKIMEVE NEGATIVE.....</b>	<b>30</b>
<b>7. SHTRIRJA HAPËSINORE E NDIKIMIT NEGATIV NË MJEDISIN E ZONËS.....</b>	<b>30</b>
<b>8. REHABILITIMI I MJEDISIT TË NDIKUAR DHE MUNDËSIA E KTHIMIT TË TIJ NË GJENDJEN E MËPARSHME.....</b>	<b>30</b>
<b>9. MASAT E MUNDSHME PËR SHMANGIEN DHE ZBUTJEN E NDIKIMEVE NEGATIVE NË MJEDIS.....</b>	<b>30</b>
<b>10. NDIKIMET E MUNDSHME NË MJEDISIN NDËRKUFITAR (NËSE PROJEKTI KA NATYRË TË TILLË).....</b>	<b>31</b>

## HYRJE

Ky raport paraprak i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis, hartohet me kerkese te subjektit Z. Fadil DULLA Person Fizik me NIPT: K72910812I. Ky subjekt, ka paraqitur kerkesen per hartimin e procedures se konsultimit me publikun prane AKM dhe do te aplikojte prane QKL-AKM per pajisjen me Leje Mjedisore te tipit B per aktivitetin ndertim i perkohshem impiant per larjen e inerteve lumore.

Objekti i vleresimit te ketij raporti eshte aktiviteti per ndertimin e perkohshem impiant per larjen e inerteve lumore. Ky aktivitet ndodhet ne Lumin Shkumbin, pranë Fshatit Kalush, Njësia Adminstrative Gosë, Bashkia Rrogozhinë, Qarku Tiranë.

Ky raport i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis, parashikon ndikimet ne mjedis qe mund te shkaktoje aktiviteti i ndertimit te perkohshem impiant per larjen e inerteve lumore, qe perdoren si lende e pare per ndertim.

Ky aktivitet, do te zhvillohet ne nje shesh me siperfaqe rreth 17 700m<sup>2</sup>.

## Sqarim:

Bazuar ne shtojcat I dhe II te ligjit Nr. 10440, date 07.07.2011 "Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis", ky aktivitet nuk perfshihet ne listen e aktiviteve qe i nenshtrohen procedures paraprake ose te thelluar te Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis.

Vleresimi i Ndikimit ne Mjedis, hartohet per te informuar publikun dhe institucionet e mbrojtjes se mjedisit mbi ndikimet ne mjedis te aktivitetit.

## Ortofoto e vendodhjes se aktivitetit





<b>Koordinatat e objektit ne sistemin Gaus-Kruge</b>		
<b>Nr.</b>	<b>Koordinatat Y</b>	<b>Koordinatat X</b>
1	<b>4382928.92</b>	<b>4549063.47</b>
2	<b>4382994.49</b>	<b>4548845.04</b>
3	<b>4383074.69</b>	<b>4548924.64</b>

## 1. INFORMACION PËR QËLLIMIN E VNM DHE METODIKËN E ZBATUAR

### Përshkrimi qëllimit dhe objektivave të VNM

Ky Raport i Vleresimit të Ndikimit në Mjedis, është hartuar bazuar në legjislacionin mjedisor për VNM dhe ka për qëllim që të parashikojë, identifikojë, vleresojë dhe parandalojë ose minimizojë ndikimin në mjedis të projektit.

Procedura e vlerësimit të ndikimit në mjedis përfshin:

- a) procesin paraprak të vlerësimit të ndikimit në mjedis;
- b) procesin e thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis.

Objektivat afatshkurter të VNM janë:

- Permiresim nga pikepamja mjedisore të projektit të propozuar;
- Siguron që burimet natyrore janë përdorur në mënyrë të duhur dhe me efikasitet;
- Siguron që është përzgjedhur alternativa më e mirë e vendodhjes së projektit.
- Siguron që janë marrë në konsideratë teknikat më të mira të Disponueshme të teknologjive të propozuar për tu aplikuar.
- Identifikon masat e duhura për zvogëlimin e ndikimeve të mundshme potenciale të projektit të propozuar;
- Mundëson informimin e vendim-marrësve, duke gjykuar në miratimin ose jo të projektit dhe kushteve që duhet të vendosen në aktin e miratimit.

Objektivat afatgjate të VNM janë:

- Siguron dhe mbron shëndetin e njeriut;
- Parashikon dhe parandalon ndryshimet/dëmtimet e pakthyeshme të mjedisit;
- Ndikon në mbrojtjen e burimeve natyrore, peisazhet e natyrës dhe komponentet përbërës të ekosistemeve;
- Permireson aspektet sociale-ekonomike të projektit
- Ndihmon në realizimin e parimit të zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit.

### Përshkrim i përmbledhur i kuadrit ligjor mjedisor dhe institucional që lidhet me projektin

Legjislacioni mjedisor është hartuar për të mbrojtur dhe parandaluar ndotjen dhe dëmtimin e komponenteve të veçante dhe të rëndësishme të mjedisit nga faktore të ndryshme, njerezore dhe natyrore. Nder ligjet me kryesore në lidhje me këtë projekt, mund të përmendim:

- Ligji Nr. 10431 datë 09.06. 2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”.
- Ligji Nr. 10440 datë 07.07. 2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”.
- Ligji Nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për Lejet e Mjedisit”.
- Ligji Nr. 10463 datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”.
- Ligji Nr.8897 datë 16.05.2002, “Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja”, i ndryshuar.
- Ligji Nr.9587, datë 20.07.2006, “Për mbrojtjen e biodiversitetit”.
- Vendim Nr. 123, datë 17.2.2011 “Për menaxhimin e zhurmave”.
- Vendim Nr. 313, dt. 09.05.2012 “Për rregulloren e mbrojtjes së publikut nga shkarkimet në mjedis”.
- Vendim Nr. 686, datë 29.07.2015 “Për zhvillimin e procedurave të VNM-se”.
- Vendim Nr. 247, datë 30.4.2014 “Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimarrjen mjedisore”.
- Vendim Nr. 628, datë 15.7.2015 “Për miratimin e rregullave teknike të projektimit dhe ndërtimit të rrugëve”.
- Udhëzim Nr. 8, dt.27.11.2007 “Për nivelet kufi të zhurmave”.

## 2. PËRSHKRIMI I MBULESËS BIMORE TË SIPËRFAQES KU PROPOZOHE TË ZBATOHET PROJEKTI.

Objekti ndodhet ne lumin Shkumbin, prane fshatit Kalush, te Njesise Adminstrative Gose, Bashkia Rrogozhine, Qarku Tirane. Terreni eshte kryesisht me relief te sheshte. Bimesia qe karakterizon kete zone eshte kryesisht bimesia tipike e shtreterve te lumenjve, ku dominon shelgu, ferra, robinje. Kulturat bujqesore te zones variojne nga me te ndryshmet, duke permendur dritherat, foragjeret, perimet, pemet frutore, agrumet, vreshtat e rrushit, etj. Sic shihet edhe nga ortofotot dhe nga fotot e zones, ky aktivitet ndodhet ne toka qe duket se kane qene me status toka bujqesore dhe pjeserisht zona pyjore, por nuk ben pjese ne zona te mbrojtura me ligj.

Ortofoto e siperfaqes ne vleresim



**Përshkrimi i zonave të mbrojtura pranë vendit ku propozohet të zbatohet projekti përfshi edhe monumentet natyrore të mbrojtura me ligj.**

Në Shqipëri, zonat e mbrojtura sidomos 10 vjeçarin e fundit, janë kthyer në një objekt të rëndësishëm pune të disa institucioneve të vendit, të cilat kanë synuar në evidentimin, ruajtjen, mirëmenaxhimin e përdorimin në mënyrë të qëndrueshme të tyre.

Aktualisht në Shqipëri zonat e mbrojtura përbëjnë rreth 10% të territorit. Ndonëse shpallja e tyre është bërë gradualisht ndër vite, duke filluar që në vitin 1940, deri në vitin 2002 ka munguar një ligj mbi të cilin të mbeshtetet kategorizimi, ruajtja e menaxhimi i këtyre zonave. Me daljen e këtij ligji në qershor të 2002 duhet thënë se ka filluar një koncept i ri që

përshtatet me atë bashkëkohor dhe që në tre vitet e fundit ka gjetur zbatim në rritjen me dyfish të territorit të vendit. Rrjeti i zonave të mbrojtura mbështetet në kategoritë menaxhuese të Qendrës Ndërkombëtare për Ruajtjen e Natyrës (IUCN).

Themelet e zonave të mbrojtura janë hedhur që në vitin 1940 me shpalljen/krijimin e Rezervatit të Parë Shtetëror të Gjuetisë (Kune- Vain-Tale) në Lezhë dhe në Parkun Kombëtar “Mali i Tomorrit” në Berat. Në vitin 1956, në mbështetje të Dekretit “Mbi gjuetinë dhe peshkimin në ujërat malorë” u krijua rezervati i gjuetisë në Rrushkull. Në vitin 1960, zyrtarisht krijohet Parku Kombëtar “Mali i Dajtit” dhe 6 vjet më vonë numri i tyre rritet në 6 (Thethi, Lura, Llogaraja, Dajti dhe Drenova). Parqe Kombëtare u shpallën zona me vlera të rralla e të veçanta natyrore, shkencore, shoqërore e rekreative, ku ruheshin të pa prekur ekosistemet natyrore dhe shërbenin për ruajtjen e florës dhe faunës së egër. Deri në vitin 1970 numri i rezervateve të gjuetisë arriti në 15 zona pyjore e lagunore. Me dekretin e vitit 1977 u bë riklasifikimi i rezervateve të gjuetisë dhe numri i tyre arriti në 25. Në vitin 1981 për herë të parë u vunë në mbrojtje shtetërore pasuritë natyrore të rralla, duke shpallur Monumente Natyre drurët e grumbuj pyjorë me vlerë shkencore, biologjike, historike e didaktike.

Në Shqipëri, Zonat e Mbrojtura janë të konsideruara si pjesë/sipërfaqe e tokës dhe/ose ujit, detare/bregdetare, të destinuara kryesisht për konservimin e biodiversitetit, burimet natyrore dhe kulturore që shoqërojnë atë/ato dhe që janë të menaxhuara në mënyrë të ligjshme dhe/ose në mënyra të tjera efektive. Rrjeti i zonave të mbrojtura është bazuar në kategoritë e menaxhimit të IUCN dhe sistemi i ndërtuar për këtë qëllim është në përputhje me sistemin ndërkombëtar IUCN.

Të gjashtë kategoritë e sistemit janë ekuivalente, të barabarta dhe të rëndësishme dhe ato përfshijnë të gjitha nivelet e ndërhyrjes njerëzore, të pranueshme për kategorinë respektive. Zona në vlerësim nuk vlerësohet si zone me status të veçante nga MM. Sic shihet edhe në hartën e mëposhtme, zona në vlerësim nuk bëjnë pjesë në zonat e mbrojtura si më poshtë:

**NDËRTIM I PËRKOHSHËM IMPIANT PËR LARJEN E INERTEVE LUMORE  
LUMI SHKUMBIN, PRANË FSHATIT KALUSH, NJËSIA ADMINISTRATIVE GOSË, BASHKIA RROGOZHINË, TIRANË**

**RRJETI I ZONAVE TË MBROJTURA NË SHQIPËRI**

VITI 2014-MARS

MINISTRIA E MJEDISIT							
Nr.	Kategoria	Qarku	Rrethi	Emëri i ZM	Miratimi	Nr.ZM	Sipërf. Ha
1	I	Kukës	Tropojë	Lumi i Gashit	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	3,000.0
2	I	Gjirokastrë	Gjirokastrë	Kardhiq	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	1,800.0
<b>KATEGORIA I Rezervat Strikt Natyror/Rezervat Shkencor - Kategoria I (RSN)</b>					<b>SHUMA I</b>	<b>2</b>	<b>4,800.0</b>
3		Shkodër	Shkodër	Thethi	VKM nr. 96, datë 21.11.1966	1	2,630.0
4	II	Dibër	Dibër	Lura	VKM nr. 96, datë 21.11.1966	1	1,280.0
5	II	Vlorë	Vlorë	Llogara	VKM nr. 96, datë 21.11.1966	1	1,010.0
6	II	Korçë	Korçë	Bredhi i Drenovës	VKM nr. 96, datë 21.11.1966	1	1,380.0
8	II	Kukës	Tropojë	Lugina e Valbonës	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	8,000.0
9	II	Durrës	Kruje	Qafë Shtamë	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	2,000.0
10	II	Dibër	Mat	Zall Gjoçaj	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	140.0
11	II	Korçë	Korçë	Prespa	VKM nr. 80, datë 18.02.1999	1	27,750.0
12	II	Vlorë	Sarandë	Butrinti	VKM nr.134, datë 20.02.2013	1	9,424.4
13	II	Tiranë,Durres		Mali i Dajtit	VKM nr.402, datë 21.06.2006	1	29,216.9
		Tirane	Tirane	Mali i Dajtit	VKM nr.402, datë 21.06.2006		26,772.7
		Durres	Kruje	Mali i Dajtit	VKM nr.402, datë 21.06.2006		2,444.2
14	II	Fier, Tiranë		Divjakë-Karavasta	VKM nr.687, datë 19.10.2007	1	22,230.2
		Fier	Lushnjë	Divjakë-Karavasta	VKM nr.687, datë 19.10.2007		19,411.1
		Fier	Fier	Divjakë-Karavasta	VKM nr.687, datë 19.10.2007		2,074.5
		Tirane	Kavaje	Divjakë-Karavasta	VKM nr.687, datë 19.10.2007		744.6
15	II	Elbasan, Diber		Shebenik-Jabllanice	VKM nr.640, datë 21.05.2008	1	33,927.7
		Elbasan	Librazhd	Shebenik-Jabllanice	VKM nr.640, datë 21.05.2008		33,760.1
		Diber, Kukes	Bulqize	Shebenik-Jabllanice	VKM nr.640, datë 21.05.2008		167.6
16	II	Gjirokastrë, Korçe		Bredhi i Hotovës-Dangelli	VKM nr.1631, datë 17.12.2008	1	34,361.1
		Permet	Permet	Bredhi i Hotovës-Dangelli	VKM nr.1631, datë 17.12.2008		33,165.3
		Korçe	Kolonje	Bredhi i Hotovës-Dangelli	VKM nr.1631, datë 17.12.2008		1,195.8
17	II	Vlore	Vlore	Karaburun-Sazan	VKM nr.289, datë 28.04.2010	1	12,428.0
	II	Berat, Elbasan		Mali i Tomorit	VKM nr.432, datë 18.07.2012	1	24,723.1
18	II	Berat	Berat	Mali i Tomorit	VKM nr.432, datë 18.07.2012		8,398.4
		Berat	Skrapar	Mali i Tomorit	VKM nr.432, datë 18.07.2012		15,045.8
		Elbasan	Gramsh	Mali i Tomorit	VKM nr.432, datë 18.07.2012		1,278.9
<b>KATEGORIA II Park Kombetar - Kategoria II (PK)</b>					<b>SHUMA II</b>	<b>15</b>	<b>210,501.4</b>
19	III	Shqipëri	Shqipëri	BioMonumente Nr.	VKM nr.676, datë 20.12.2002	348	0.0
20	III			GjeoMonumente Nr.	VKM nr.676, datë 20.12.2002	398	0.0
	III			ShumaBio&Gjeo Nr.		746	0.0
21	III	Gjirokastrë	Gjirokastrë	Bredhi i Sotirës	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	1,740.0
22	III	Gjirokastrë	Gjirokastrë	Zhej	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	1,500.0
23	III	Vlorë	Delvinë	Syni i Kallër	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	180.0
24	III	Dibër	Dibër	Vlashaj	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	50.0
				Shuma MonNatyre Nr.		4	0.0
				Totali MonNatyre Nr	VKM nr.676, datë 20.12.2002	750	0.0
<b>KATEGORIA III Monument Natyre - Kategoria III (MN)</b>					<b>SHUMA III</b>		<b>3,470.0</b>
25	IV	Vlorë	Vlorë	Karaburun	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	20,000.0
26	IV	Korçë	Devoll	Cangonj	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	250.0
27	IV	Berat	Skrapar	Bogovë	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	330.0
28	IV	Korçë	Korçë	Krastafillak	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	250.0
29	IV	Elbasan	Librazhd	Kulturman	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	3,600.0
30	IV	Fier	Fier	Pishë Poro	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	1,500.0
31	IV	Lezhë	Lezhë	Berzanë	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	880.0
32	IV	Fier	Fier	Levan	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	200.0
33	IV	Berat	Berat	Balloll	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	330.0
34	IV	Elbasan	Elbasan	Qafë Bushi	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	500.0
35	IV	Durrës	Durrës	Rrushkull	Urdhër MB nr.2, datë 26.12.1995	1	650.0
36	IV	Vlorë	Delvinë	Rrezomë	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	1,400.0
37	IV	Kukës	Has	Tej Drini Bardhë	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	30.0
38	IV	Korçë	Kolonjë	Gërmenj-Shelegur	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	430.0
39	IV	Elbasan	Librazhd	Polis	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	45.0
40	IV	Elbasan	Librazhd	Stravaj	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	400.0
41	IV	Elbasan	Librazhd	Sopot	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	300.0
42	IV	Elbasan	Librazhd	Dardhë-Xhyrë	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	400.0
43	IV	Shkodër	Shkodër	Liqeni i Shkodres	VKM nr.684, datë 02.11.2005	1	26,535.0
44	IV	Lezhë	Lezhë	Kune-Vain-Tale	VKM nr.432, datë 28.04.2010	1	4,393.2
45	IV	Lezhë	Kurbin	Patok-Fushëkuqe-Ishem	VKM nr.995, datë 03.11.2010	1	5,000.7
46	IV	Diber, Kukes		Korab-Kontnik	VKM nr.898, datë 21.12.2011	1	55,550.2
		Diber	Diber	Korab-Kontnik	VKM nr.898, datë 21.12.2011		20,663.4
		Kukës	Kukes	Korab-Kontnik	VKM nr.898, datë 21.12.2011		34,886.6
<b>IV/1 Park Natyror Rajonal</b>							
47	IV/1	Diber	Mat	Liqeni i Ulzez dhe zona perreth tij	VKQ nr. 16, datë 03.04.2013	1	4,206.0
<b>KATEGORIA IV Rezervat Natyror I Menaxhuar/Park Natyror - Kategoria IV (RNM)</b>					<b>SHUMA IV</b>	<b>23</b>	<b>127,180.1</b>
48	V	Korçë	Devoll	Nikolicë	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	510.0
49	V	Korçë	Pogradec	Pogradec	VKM nr. 80, datë 18.02.1999	1	27,323.0
50	V	Vlorë	Vlorë	Vjosë-Nartë	VKM nr.680, datë 22.10.2004	1	19,738.0
51	V	Shkodër	Shkodër	Lumi Buna-Velipojë	VKM nr.682, datë 02.11.2005	1	23,027.0



**NDËRTIM I PËRKOHSHËM IMPIANT PËR LARJEN E INERTEVE LUMORE  
LUMI SHKUMBIN, PRANË FSHATIT KALUSH, NJËSIA ADMINISTRATIVE GOSË, BASHKIA RROGOZHINË, TIRANË**

52	V	Tiranë,Diber,Eibasan		M.Gropa-Bizë-Martanesh	VKM nr.49, datë 31.01.2007	1	25,266.4
		Tirane	Tirane	M.Gropa-Bizë-Martanesh	VKM nr.49, datë 31.01.2007		13,213.6
		Diber	Mat	M.Gropa-Bizë-Martanesh	VKM nr.49, datë 31.01.2007		3,016.7
		Diber	Bulqize	M.Gropa-Bizë-Martanesh	VKM nr.49, datë 31.01.2007		9,036.1
	<b>KATEGORIA V</b>	<b>Peizazh i Mbrojtur - Kategoria V (PM)</b>			<b>SHUMA V</b>	<b>5</b>	<b>95,864.4</b>
53	VI	Dibër	Dibër	Luzni-Bulaç	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	5,900.0
54	VI	Korçë	Kolonjë	Piskal-Shqeri	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	5,400.0
55	VI	Lezhë	Mirditë	Bjeshka e Oroshit	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	4,745.0
56	VI	Korçë	Pogradec	Guri i Nikës	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	2,200.0
	<b>KATEGORIA VI</b>	<b>Zone e Mbrojtur e Burimeve të Natyrore të Menaxhuara - Kategoria VI (ZMBNM)</b>			<b>SHUMA VI</b>	<b>4</b>	<b>18,245.0</b>
	<b>TOTALI i ZM</b>					<b>16%</b>	<b>799</b>
							<b>460,060.9</b>

Sip. Republikës	2,874,800.00	ZM pa Sip.Detare	15.64%	446,799.7
		Sip. Detare, Ha	0.5%	13,261.2
			Karaburun-Sazan	12,428.0
			Butrint	833.2
		Sip. Bregdetare dhe Detare	%/Totalit ZM	25.95%
				119,401.6

Shkurtesat:

a	VKM	Vendim i Keshillit të Ministrave			
b	VKO	Vendim i Keshillit të Qarkut			
c	MB	Ministria e Bujqesise			
d	ZM	Zone e Mbrojtur			

**LISTA E ZONAVE RAMSAR**

1	RAMSAR	Fier	Lushnje, Fier	Laguna Karavastase_Pisha Divjakes	VKM nr.413, datë 22.08.1994	Nr.Site 781, dt.29.11.1995	20,000.0
2	RAMSAR	Vlore	Sarande	Kanali Çukes-Butrint-Kepi Stillos	VKM nr.531, datë 31.10.2002	Nr.Site 1290, dt.28.3.2003	13,500.0
3	RAMSAR	Shkoder	Shkoder	Liçeni Shkodres-Lumi Bunes	VKM nr.683, datë 02.11.2005	Nr.Site 1598, dt.2.2.2006	49,562.0
4	RAMSAR	Korce	Korce,Devoll	Liçeni i Prespave	VKM nr. 489, dt. 13.06.2013	Nr.Site 2151, dt 03.07.2013	15,118.6
	<b>TOTALI</b>					<b>%/Totali Republikës</b>	<b>3.42%</b>
							<b>98,180.6</b>

DREJTORIA E BIODIVERSITETIT DHE ZONAT E MBROJTURA  
SEKTORI I ZONAVE TË MBROJTURA  
Adresa: Rruga e Durrësit, Nr. 27, Tiranë.  
[www.mjedisi.gov.al/](http://www.mjedisi.gov.al/)

**Monumentet Natyrore të Rrethit Kavaje.(Sipas VKM 676)**

Plazhi i Gjeneralit	Karsti në gjipsin e Mengajve
Faleza e Bardhorit	Burimet e kripura të Golemasit
Plazhi i Carrinës	Dafina e Kalase se Turre
Fosilet detare të Thartorit	Gurret ne Rrjesht
Burimet sulfurore të Fliballies	Lisi i Cikalleshit
Shpellat karstike në gjips	



### **Lagunat Bregdetare**

Lagunat bregdetare ose tokat e lagura në bregdet janë ekosistemet më të rëndësishëm të biodiversitetit shqiptar dhe për vlerat socioekonomike që ofrojnë. Vetëm në rreth 3% të sipërfaqes së vendit që mbulohet nga këto zona, përmbledhet rreth 70% e llojeve të ruazorëve të vendit. Ato paraqiten si një zinxhir që përshkon të gjithë vijën bregdetare ku përmendim nga veriu në jug Velipojën, sistemin e Kune-Vainit, Patokun, Rrushkullin, Karavastanë, Nartën, Orikumin, Butrintin, etj. Veçanërisht të rëndësishme shfaqen ato për grupin e shpendëve, kryesisht për dimërimin e shpendëve shtegtarë të ujit, dhe të amfibëve duke u ndjekur nga reptilët dhe gjitarët.

### **Rëndësia e Shqipërisë për llojet shtegtare**


Shqipëria është një udhëkryq i rëndësishëm për migrimin e shpendëve, lakuriqve të natës dhe insekteve. Çdo vit takohen rreth 70 lloje shpendësh uji me një popullatë totale prej 180.000 individësh në Shqipëri gjatë dimrit. 2 nga 9 llojet e shpendëve endemikë Europianë janë gjithashtu prezent në vendin tonë (Trishtili me mustaqe dhe Thëllëza e Malit). Gjithashtu 5 lloje të rrezikuara shpendësh takohen në Shqipëri si Pelikani kaçurel, Pata ballëbardhë, etj. Lagunat bregdetare dhe liqenet e mëdhenj në brëndësi të vendit përfaqësojnë zona të rëndësishme veçanërisht për dimërimin e shpendëve migratorë. Së paku katër prej këtyre ligatinave (Laguna e Karavastasë, Laguna e Nartës, Liqeni i Shkodrës dhe ai i Ohrit) mund të konsiderohen si Zona të një Rëndësie Ndërkombëtare për shpendët, të njohura me emrin IBA (Important Bird Area), dhe plotësojnë kushtet për të qënë si zona Ramsar (Karavastaja, Butrinti dhe Shkodra janë shpallur të tilla), me më shumë se 20,000 mijë shpendë dimëronjës uji secila. Shqipëria si një vend mesdhetar i pasur me gëlqerorë dhe shpella, ofron varietete habitatesh që mund të përdoren si vende jetese për lakuriqët e natës. Rreth gjysma e llojeve të gjetura të lakuriqëve të natës njihen si lloje që jetojnë në shpella. Tynelet e ndërtuara në kohët e shkuara për qëllime ushtarake dhe shumica e minierave që nuk përdoren më, janë vende të vlefshme për lakuriqët e natës. Disa nga këto janë tashmë të populluara nga kolonitë e lakuriqëve të natës. Një rast i veçantë është Shpella e Trenit që ndodhet në hyrje të Liqenit të Prespës së Vogël, dhe që është mbushur nga sedimentet e shkarkuara nga devijimi i Lumit Devoll këto 20-25 vjetët e fundit. Meqënëse kjo shpellë është bërë më e vogël dhe e tharë, ka humbur rëndësinë e saj për të bujtur koloni të vegjëlsh për disa lloje lakuriqësh, veçanërisht për *Miniopterus schreibersi*, *Myotis capaccinii* dhe *Myotis daubentoni* dhe *Eptesicus serotinus*.

### 3. INFORMACION PËR PRANINË E BURIMEVE UJORE NË SIPËRFAQEN E KËRKUAR NGA PROJEKTI DHE NË AFËRSI TË SAJ.

Ne zonen e zhvillimit te aktivitetit, i cili zhvillohet ne territorin e Bashkise Rrogozhine, ka burime ujore, nje nder burimet kryesore eshte Lumi Shkumbin, pikerisht ne brigjet e te cilit do te zhvillohet aktiviteti, burim tjetër eshte edhe Deti Adriatik. Ne kete zone identifikohen keto burime ujore: Burimi ujqor me i afert i kesaj siperfaqeje eshte Lumi Shkumbin, i cili ndodhet rreth 100m ne vije ajrore ne perendim te ketij instalimi.

Burim tjetër ujqor i rendesishem eshte Laguna e Karavastase, Divjake e cila ndodhet rreth 14km ne vije ajrore ne jugperendim te prones, si dhe Deti Adriatik i cili ndodhet rreth 13km ne vije ajrore ne perendim te objektit. Me poshte paraqitet nje pamje satelitore e distancave qe ruan objekti nga burimet ujore.

**Paraqitja ne pamje satelitore e pozicionit dhe lidhja me burimet ujore te zones**



Zona e mbrojtur me e afert me aktivitetin tone eshte Laguna e Karavastase, pjese e Parkut Kombetar te Divjakes.



Lagunat bregdetare ose tokat e lagura në bregdet janë ekosistemet më të rëndësishëm të biodiversitetit shqiptar dhe për vlerat socioekonomike që ofrojnë. Vetëm në rreth 3% të sipërfaqes së vendit që mbulohet nga këto zona, përmbledhet rreth 70% e llojeve të ruazorëve të vendit. Ato paraqiten si një zinxhir që përshkon të gjithë vijën bregdetare ku përmendim nga veriu në jug: Velipojën, sistemin e Kune-Vainit, Patokun, Rushkullin, Karavastanë, Nartën, Orikumin, Butrintin, etj. Veçanërisht të rëndësishme shfaqen ato për grupin e shpendëve, kryesisht për dimërimin e shpendëve shtegtarë të ujit, dhe të amfibëve duke u ndjekur nga reptilët dhe gjitarët.

**Parku Kombëtar Divjakë-Karavasta** është një zonë e mbrojtur në zonën bregdetare të Shqipërisë, përbëhet nga ekosisteme komplekse, shumë të pasura në biodiversitet dhe burime natyrore. Është shpallur edhe si zonë e mbrojtur natyrore për shpendët e ujit, si ligatinë me rëndësi nderkombëtare sipas Konventës së Ramsarit, që nga viti 1995. Parku Kombëtar Divjakë-Karavasta gjendet 90 km nga kryeqyteti i Tiranës, 60 km nga Durrësi qyteti-port më i madh, dhe 80 km nga Aeroporti Ndërkombëtar i vetëm në Shqipëri. Ai kufizohet nga lumi Shkumbin në veri, nga kodrat e Divjakës në Lindje, nga kanali i Myzeqesë dhe lumi Seman në jug, dhe laget nga deti Adriatik në perëndim.



Zona e parkut kombëtar Divjakë-Karavasta është zona më e rëndësishme komplekse e Shqipërisë për sa i përket biodiversitetit. Kjo zonë strehon përqendrimin më të lartë të shpendëve ujore rreth 51 000 individë, dhe rreth 500 çifte folenizues në Shqipëri. 89 specie të ndryshme që përfaqësojnë grupet e molusqeve, insekteve, amfibëve, zvarranikëve, zogjve dhe gjitarëve, të pranishme në zonën e parkut, janë konsideruar si të kërcënuara në Shqipëri. 42 specie i përkasin kategorive shumë të rrezikuara, duke përfshirë rrezik kritik, të rrezikuara dhe vulnerable. Zona është e mirënjohur jo vetëm për bukurinë e saj natyrore dhe biodiversitetin, por edhe për aktivitetet tradicionale ekonomike dhe turizmin. Aktivitetet kryesore tradicionale përfshijnë, aktivitetet bujqësore, blegtorale, dhe peshkim etj. Bimët që kultivohen në zonën e Parkut Kombëtar Divjakë-Karavasta përfshijnë, shalqinin, karrotën, lakrën, lulëlakrën, brokolin, domaten, pataten, fasulen, llojet e ndryshme të frutave, ulliri, dhe vreshta etj. Blegtoria është një tjetër aktivitet tradicional duke mbarështuar gjedhin dhe delet për produkte bulmeti dhe mish. Peshkimi është një aktivitet i rëndësishëm dhe një burim thelbësor i të ardhurave për disa fshatra përgjatë bregut të lagunës Karavastasë, lumit Seman dhe detit Adriatik. Në kulturat bujqësore që kultivohen dhe prodhohen në zonën e studimit përfshihen: drithërat, patatet, fasulet, perimet e ndryshme dhe drurët frutorë, vaji i ullirit, vera, qumështi dhe produktet e mishit, mjalti, lëkura, leshi, etj., të cilat plotësojnë nevojat e konsumit vendor si dhe sigurojnë një pjesë të konsiderueshme furnizimi në nivel kombëtar. Mbarështimi i gjedhëve, deleve, dhive, derrave, kuajve dhe gomarëve është një mënyrë tradicionale e jetesës për komunitetet vendore, ndërkohë që ka disa lloje të kafshëve shtëpiake në këtë zonë.

Zona ofron mundësi të mira për zhvillimin e ekoturizmit. Parku Kombëtar i Divjakës, i njohur për pyllin me pisha, plazh dhe Laguna me burimet e saj të peshkimit, habitatet e llojeve të kërcënuara globalisht të tilla si Pelikani Dalmat, ofron një ambient unik për pushuesit që të kalojnë një kohë të mirë dhe për shkencëtarët të kenë një punë efektive. Rreth 300.000 pushues vizitojnë plazhin e Karavastasë çdo vit, me rreth 8000 vizitorë në ditë në verë. Shumica e vizitorëve vijnë me makinë. Kjo tejkalon kapacitetin mbajtës të zonës. Plazhi i Divjakës ka një shtrirje prej rreth 15 kilometra me rërë të bardhë (250 m gjerësi në disa zona), veshur me pyje me pisha, dhe është zone bregdetare për mijëra turistë dhe udhëtarëve ditorë nga zona jug-qendrore e Shqipërisë.

Megjithatë, zhvillimi i turizmit është i lidhur me zgjidhjen e disa çështjeve të tilla si menaxhimi i duhur i mbetjeve urbane, përmirësimi i trajtimit të ujërave të zeza, kontrolli dhe respektimi i rregullave të planifikimit hapësinor për ndërtesat dhe infrastrukturën turistike. Mushkonjat janë gjithashtu shqetësim i madh.



Zhvillimi turistik përgjatë plazhit dhe brenda pyllit është duke krijuar një kërcënim serioz për Zonen Ramsar, përmes ndotjes, rreziku nga zjarri dhe shqetësimit për kafshë të egra. Infrastruktura në zonën e plazhit është e pamjaftueshëm për të përballuar rritjen e numrit të vizitorëve. Rruga nuk është mjaftueshëm e madhe për të përballuar rritjen e përdorimit të makinave dhe nuk ka hapësirë parkimi në plazh dhe në zonën pyjore. Nuk ka asnjë okatm për menaxhimin e ujërave të zeza apo të ngurta mbetjeve në vend – aktualisht mbetjet e ujërave të zeza të papërpunuara shkarkohen në zonën e pyjeve, mbeturinat e ngurta janë hedhur në pyll dhe toka të kripura, dhe plazhi është mbushur me mbeturina dhe mbetje të ngurta. Të gjitha këto okatma jo vetëm përfaqësojnë një rrezik për ruajtjen e natyrës, por ulin cilësinë e përvojës së vizitorëve në plazh. Peshkimi është një veprimtari e rëndësishme dhe një burim i rëndësishëm të ardhurash për disa prej fshatrave përgjatë brigjeve të lagunës së Karavastasë, lumit të Semanit dhe detit Adriatik. Peshkimi mbështet jetesën e mjaft njësive ekonomike familjare qoftë në funksionin tregtar, apo qoftë edhe si mjet jetese.

### **Parku Kombëtar Divjakë-Karavasta**

Parku Kombëtar Divjakë-Karavasta shtrihet në gjashtë njësi administrative të qeverisjes vendore si bashkia e Divjakës dhe komunat Remas, Tërbuf, Gradishtë, Gosë dhe Libofshë. Administrohet nga një zyrë e veçantë nën mbikëqyrjen e Komitetit të Menaxhimit të përbërë nga Ministria e Mjedisit, ministritë e linjës, pushteti vendor dhe palët e interesuara.

Kjo zonë konsiderohet si një nga zonat me vlera të veçanta natyrore dhe të biodiversitetit. Zonat kryesore të parkut Kombëtar Divjake-Karavasta përbëhen nga Laguna e Karavastasë, shtretërit e lumenjve të vjetër Seman dhe Shkumbin, emisarët e Terbufit dhe Myzeqesë, rezervuarët bujqësore, tokat bujqësore, pyjet përgjatë anëve të lumenjve Seman dhe Shkumbin, pylli Mesdhetar me pisha, pyjet dhe zonat e pyllezuara në kodrat e Divjakës, pemët frutore, ullishtat, vreshtat dhe agrumet.

## Inventari



Zona e parkut kombëtar shquhet për popullatat e ndryshme floristike dhe faunistike, speciet endemike, subendemike, të rralla, të kërcënuara dhe të rrezikuara. Pylli Mesdhetar natyror me pisha është pylli i vetëm bregdetar në kushte natyrore në Shqipëri. Laguna e Karavastase dhe zona përreth është ekosistemi më i rëndësishëm për shpendët e ujit. Në Lagunën e Karavastasë ndodhet i vetmi vend shumimi për Pelikanin (*Pelecanus crispus*), një specie e rrezikuar globalisht. Llojet kryesore të peshkut janë *Anguilla Anguilla*, *Sparus auratus*, *Dicentrarchus labrax*, *Aphanius fasciatus* dhe *Gobius bucchichi* etj. Divjaka shquhet gjithashtu mbarështimin e buallicës (*Bubalus bubalis*), e cila gjendet vetëm në këtë zonë dhe është një specie e mbrojtur në Shqipëri.

### Liqenet

Liqenet në brendësi të vendit dhe rrjeti hidrik ndikojnë në rritjen e diversitetit biologjik e pejsazhor të vendit. Tre janë liqenet kryesore që Shqipëria ndan me fqinjët e saj Liqeni i Shkodrës, Liqeni i Ohrit dhe Liqenet e Prespës (i Madhi dhe i Vogli). Gjithashtu rreth 247 liqene natyrorë të tipeve dhe madhësive të ndryshme dhe një numër i konsiderueshem liqenesh artificialë ndodhen në Shqipëri.

### Lumenjtë

Lumenjtë kryesorë të vendit janë: Drini, Buna, Mati, Shkumbini, Semani, Vjosa, Erzeni, Ishmi, Bistrica dhe Pavllo, të cilët ndahen në 6 basenet lumor. Ato kanë një efekt të rëndësishëm në të gjithë natyrën e vendit dhe një ndikim të drejtpërdrejtë në biodiversitetin bregdetar. Me tepër vlera paraqiten lumenjtë dhe përrenjtë malore të cilët përmbledhin mjaft habitate të veçantë dhe lloje endemike.

### Gjendja e treguesve mjedisor, ndikimi në mjedis dhe tendenca

AKM ka publikuar raportin e Gjendjes në Mjedis prej vitesh i cili ka prezantuar gjendjen e mjedisit në përgjithësi dhe të cilësisë së ajrit urban në veçanti duke ofruar një vlerësim real bazuar në të dhënat ekzistuese nga sistemet e monitorimit të cilësisë së ajrit .


### Situata e cilësisë së ajrit urban në vendin tonë

Vlerësimi i situatës nga pluhurat (PM10, PM2.5) Grimcat e pluhurit (PM) janë një përzierje e aerosoleve ( të ngurta ose të lëngëta ) që përfshin një diapason të gjerë në madhësi dhe



kompozime kimike. PM10, PM2.5 i referohet grimcave me diameter 10 dhe 2.5 micrometer ose më të vogël, dhe emetohet direkt në atmosferë si grimca primare ose formohet si rezultat i emisioneve të SO<sub>2</sub>, NO<sub>x</sub>, NH<sub>3</sub> dhe NMVOC PM emetohen nga shumë burime antropogjenike si djegia e lëndës djegëse, ndërtimet, pluhuri natyral pezull, kripa e detit etj. PM mund të shkaktojë dhe përkeqësojë sëmundjet e zembrës dhe mushkrive, goditje në zemër dhe aritmi. PM mund të dëmtojë sistemin nervor qendror, sistemin prodhues dhe mund të shkaktojë kancer. Një nga rezultatet e ekspozimit të PM mund të shkaktojë vdekje të parakohshme.

Grafiku nr. 1 Vlerat mesatare vjetore të PM10



Në grafikun nr.1 janë dhënë vlerat mesatare vjetore të PM10 në 7 stacione monitorimi, 2 stacione në Tiranë dhe nga 1 stacion në qytetet Durrës, Shkodër, Elbasan, Vlorë dhe Korçë. Siç vihet re dhe nga grafiku kemi tejkalim të vlerës kufi të BE prej 40µg/m<sup>3</sup> në tre stacione monitorimi në stacionin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Ministrisë Mjedisit dhe Elbasanit. Të tre stacionet janë stacione me burim ndotje trafikun ku numri i makinave që qarkullojnë në rrugët pranë stacioneve është shumë i lartë.


Në stacionin e AKM në ndotjen e ajrit nga PM10 përveç shkarkimit të automjeteve ndikon edhe pluhuri i rrugëve dhe ndërtimet. Vlera më e lartë ditore është monitoruar në muajin Prill dhe është 142.55 µg/m<sup>3</sup> nga 50 µg/m<sup>3</sup> që është standarti ditore i BE.

Problematike mbetet numri i ditëve që tejkalon standartin ditore të BE-së (50 µg/m<sup>3</sup>) në 4 stacione: në stacionin e Tirana AKM numri i ditëve të tejkaluara nga 35 ditë të lejuara është 190%, në stacionin e Tirana MM numri i ditëve të tejkaluara është 77%, në stacionin e Elbasanit numri i ditëve të tejkaluara është 63% dhe në stacionin e Korçës numri i ditëve të tejkaluara është 80%. Në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm jepen numri i ditëve që tejkalon standartin ditore të BE-së.

Tabela nr 2. Numri i ditëve që tejkalon standartin ditor të BE-së. Standarti i BE-së = 50 µg/m<sup>3</sup>


PM10 (ditore )	Numri i diteve te tejkaluar	Numri i diteve te lejuara
Tirana AKM	102	35
Tirane MM	62	35
Durres	ska tejkalim	35
Shkoder	3	35
Elbasan	57	35
Vlore	2	35
Korce	63	35

Grafiku Nr 2. Numri i ditëve që tejkalojnë standartin e BE



PM2.5 janë grimcat e pluhurit me diametër të barabarta dhe më të vogël se 2.5 mikron, ndryshe quhen dhe grimcat ultrafine. Këto grimca janë të rrezikshme për shëndetin e popullatës pasi depërtojnë thellë në mushkri duke shkaktuar probleme serioze të cilat të çojnë dhe në vdekje të parakohshme.

Grafiku nr 3. Vlerat mesatare vjetore të PM2.5




#### Vlerësimi i situatës nga SO<sub>2</sub> ( Dioksid Squfuri)

SO<sub>2</sub> është formuar nga oksidimi i sqfurit dhe kryesisht nga djegia e lëndës djegëse me përmbajtje sqfuri. Sektori i prodhimit të energjisë elektrike është burimi kryesor i SO<sub>2</sub>. SO<sub>2</sub> gjithashtu mund të ndihmojë në formimin e grimcave dytësore sulfate dhe formimin e shiut acid.

SO<sub>2</sub> është një ndotës që shkakton probleme serioze në shëndetin e popullatës si përkeqësimin e astmës si dhe redukton funksionin e mushkrive dhe irriton aparatit respiratorar. Kjo mund të shkaktojë dhimbje koke, shqetësim dhe ankth. SO<sub>2</sub> ndihmon në formimin e shiut acid, impaki i të cilit mund të jetë i dukshëm duke shkaktuar dëmtimin e pyjeve dhe ekosistemin e liqeneve dhe lumenjve.

Grafiku nr 5. Vlera vjetore e SO2



Në grafikun nr 5 janë dhënë vlerat mesatare vjetore të SO2 në qytetet kryesore të vendit tonë si Tiranë, Durrës, Shkodër, Vlorë dhe Korçë dhe siç vihet re dhe nga grafiku vlerat e monitoruara të SO2 janë të ulta. Po ti referohemi vlerave ditore dhe orare të monitoruara vërejmë se nivelet e tyre janë me të uleta në krahasim me standartin orar dhe ditore të BE-së. (Standarti orar është 350 µg/m<sup>3</sup> dhe standarti ditor është 125 µg/m<sup>3</sup>) Siç është përmendur dhe më lart SO2 kalon në formën e shiut acid dhe në formën e grimcave të pluhurit duke ndikuar në mënyrë indirekte në shëndetin e popullatës dhe në ekosistem. Po ti referohemi dhe vlerave orare dhe ditore në asnjë nga stacionet nuk kemi tejkalim të standartit të BE-së. Kjo është paraqitur dhe në tabelën e mëposhtme ku janë dhënë numri i orëve dhe ditëve të lejuara në vit.

Tabela Nr. 3. Numri i ditëve dhe orëve që tejkalon standartin e BE-së të SO<sub>2</sub>

Standarti orar i BE = 350 µg/m<sup>3</sup>


Standarti ditor i BE = 125 µg/m<sup>3</sup>

SO2	Numri i diteve te tejkaluar	Numri i oreve te lejuara	Numri i diteve te lejuar
Tirana AKM	ska tejkalim	24	3
Tirane MM	ska tejkalim	24	3
Durres	ska tejkalim	24	3
Shkoder	ska tejkalim	24	3
Elbasan	ska tejkalim	24	3
Vlore	ska tejkalim	24	3
Korce	ska tejkalim	24	3

Vlerësimi i situatës për NO<sub>2</sub> (Dioksid Azoti)

NO<sub>x</sub> është një ndotës që emetohet në atmosferë si rezultat i djegies së lëndës djegëse nga proceset industriale dhe sektori i transportit rrugor. NO<sub>x</sub> është grup gazesh i përbërë nga NO (Monoksidi i Azotit) dhe NO<sub>2</sub> (Dioksidi i Azotit). NO përbën pjesën më të madhe të emisioneve të NO<sub>x</sub> dhe ndihmon në formimin e ozonit dhe grimcave të pluhurit. NO<sub>2</sub> është i lidhur me efekte të padëshiruara në shëndet, ky mund të dëmtojë mëllçinë, mushkритë, shpretkën dhe gjakun. Ashtu si SO<sub>2</sub> dhe NO<sub>2</sub> ndikon në formimin e shiut acid dhe në eutrofikimin e tokës dhe ujit.

Grafiku nr 6. Vlera vjetore e NO2



Për NO2 burimi kryesor i ndotjes është shkarkimi i automjeteve dhe siç vihet re nga grafiku nivelet më të larta janë monitoruar në stacionet e instaluar pranë rrugëve me trafik të rënduar. Në Tiranë stacioni është instaluar në Ministrinë e Mjedisit ku numri i makinave që qarkullojnë në rrugë është i lartë gjatë gjithë ditës. Po ashtu dhe nivelet e NO2 janë 35.01 µg/m<sup>3</sup> dhe përafrohen me standartin e BE-së i cili është 40 µg/m<sup>3</sup>. Gjithashtu dhe në stacionin e Elbasanit i cili është stacion trafiku nivelet e NO2 janë 32.67 µg/m<sup>3</sup>. Në stacionet e tjera nivelet e NO2 janë të ulëta në krahasim me standartin e BE-së. Po ti referohemi dhe vlerave orare në asnjë nga stacionet nuk kemi tejkallim të standartit të BE-së. Kjo është paraqitur dhe në tabelën nr 4 ku janë dhënë numri i orëve të lejuara në vit.

Tabela Nr 4. Numri i tejkalimeve te standarti i BE për NO2


Standarti orar i BE = 200 µg/m<sup>3</sup>

NO <sub>2</sub> (orare)	Numri i orëve te tejkaluar	Numri i orëve te lejuara
Tirana AKM	S'ka tejkalim	18
Tirane MM	S'ka tejkalim	18
Durres	S'ka tejkalim	18
Shkoder	S'ka tejkalim	18
Elbasan	S'ka tejkalim	18
Vlore	S'ka tejkalim	18
Korce	S'ka tejkalim	18

### Vlerësimi i situatës nga ozoni (O3)

Ozoni i nivelit të ulët të troposferës nuk emetohet direkt në atmosferë, ai formohet si rezultat e zinxhirit të reaksioneve kimike me gazet pararendëse të emetuara në atmosferë si NO<sub>x</sub>, CO, NMVOC dhe CH<sub>4</sub> në prani dhe të rrezatimit diellor. Niveli i lartë i ozonit mund të shkaktojë problem të shëndetit respirator duke zvogëluar funksionimin e mushkrive, përkeqësimin e astmës dhe sëmundje të tjera të mushkrive deri në vdekje të parakohshme. Ozoni gjithashtu është gaz me efekt serë duke kontribuar në ngrohjen e atmosferës.


Grafiku nr7. Vlera vjetore e O3



#### Vlerësimi i situatës nga CO (monoksidi i karbonit)

Monoksidi i Karbonit (CO) emetohet në atmosferë për shkak të djegies jo të plotë të lëndës djegëse. Burimet kryesor të shkarkimit të CO në ajër janë transporti rrugor, biznesi, shtëpitë dhe industria. CO hyn në reaksion me ndotësit e tjerë duke prodhuar ozonin e niveleve të ulëta të atmosferës. Monoksidi i karbonit (CO) është një ndotës që në nivele të larta mund të shkaktojë probleme në zemër dhe të dëmtojë sistemin nervor. Ky gjithashtu mund të shkaktojë dhimbje koke, marramendje dhe lodhje.

Grafiku nr10. Vlera vjetore e CO




Bazuar në analizën e të dhënave të monitoruara gjatë vitit 2014 rezulton se nivelet më të larta janë monitoruar në stacionin e Tirana MM dhe në stacionin e Korçës. Burimi kryesor në stacionin e Ministrisë së Mjedisit është numri i madh i automjeve që qarkullojnë në rrugën e Durrësit duke shkarkuar në atmosferë nivele të larta të monoksidit të karbonit. Automjetet që qarkullojnë në këtë rrugë janë të moshave të ndryshme por dhe karburanti që ato përdorin nuk është e një cilësie të mirë. Ndërsa në stacionin e Korçës niveli i lartë i CO është përshkak të përdorimit të druve të zjarrit si lëndë djegëse për ngrohjen e banesave.

#### Vlerësimi i situatës nga Benzeni

NMVOCs (Komponimet volatile organike pa metan) prodhojnë oksidant fotokimik në reaksion me NOx në prezencë të rrezatimit diellor. Komponimet organike antropogjene emetohen nga burime të ndryshme përfshi përdorimin e bojrave, transportin rrugor, pastrimi në të thatë dhe përdorimi i solventeve të ndryshme. NMVOCs përfshijnë kimikate të ndryshme si benzene (C6H6) dhe 1, 3 butadiene rrezikojnë direkt shëndetin human, gjithashtu janë dhe pararendës të ozonit të nivelit të ulët të atmosferës.

Grafiku nr11. Vlera vjetore e Benzeni



### Zhurmat

Nuk ka monitorim të nivelit të zhurmave në zonën në vlerësim, monitorimet janë kryer për disa pika të qyteteve kryesore duke qenë se këto qytete kanë në disa pika të tyre trafik të rënduar dhe zhvillime dinamike në fushën e ndërtimit të objekteve të banimit.

### Metodologjia e matjeve

Metodologjia e matjeve bëhet konform direktivave të CE dhe OBSH.

Ligji shqiptar Nr. 9774, dt 12. 07. 2007 "Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis". Directive 2002/49/EC of the European Parliament and of the Council of 25 June 2002. ISO 1996-2: 1987 Guidelines for Community Noise, WHO.

Aparati i përdorur është i tipit Sound Level Meter EXTECH 407764 RS-232 /Datalogger me një korigjim  $\pm 0.5$  dB (A) dhe si kalibrator OSHA Tip GenRad 1562-A. Programi i monitorimit të zhurmave urbane 2014 ka përfshirë 31 pika monitorimi në qytetet Tiranë, Vlorë, Fier, Sarandë dhe Korçë, në të cilat është realizuar matja e nivelit të zhurmave brenda metodologjisë së përcaktuar, janë përpunuar dhe analizuar të dhënat dhe për çdo pikë monitorimi vlerat mesatare të nivelit të zhurmave urbane. Nga ky monitorim vihet re se ka ndryshime të vogla me rritje të nivelit të zhurmës të disa pikave krahasuar me vitin 2011 (monitorimi i fundit) si dhe me ulje në disa të tjera.

Analiza e pikave të zgjedhura të marrjes së mostrës dhe koordinatat gjeografike të tyre (gjatësi dhe gjerësi gjeografike)

Tabela 1. Vlera mesatare e nivelit të zhurmave të qyteteve të monitoruara, për Ditën dhe Natën.

Qytetet	LAeq/Ditën dB (A)	LAeq/Natën dB (A)
Tirane	67.9	57.3
Fier	60.9	48.5
Vlore	62.2	50.4
Sarande	62.3	46.1
Korce	61.9	43
<b>Standarti BE</b>	<b>55</b>	<b>45</b>


Niveli mesatar i zhurmave LAeq/Ditën dhe LAeq/Naten, për qytetet Tiranë, Fier, Vlorë dhe Sarandë është mbi standartin e BE-së dhe Ligjit Shqiptar. Qyteti i Korçës është me nivele zhurmash për ditën mbi standartin, ndërsa për natën kemi nivel mesatar brenda standartit.




### Ujërat, Gjëndja e treguesve mjedisor, ndikimi në mjedis dhe tendenca

Monitorimi i cilësisë së ujërave sipërfaqësore, lumenj, liqene dhe zona bregdetare Në lumenjte kryesore të vendit Drin, Bunë, Mat, Ishëm, Erzen, Seman dhe Vjosë monitorimi realizohet nga Agjencia Kombetare e Mjedisit(AKM), në 34 stacione duke përfaqësuar gjithë gjatesinë e lumit në rrjedhjen e sipërme, në rrjedhjen e mesme dhe në rrjedhjen e poshtme. Monitorimi i liqeneve Ohër, Shkodër, Prespë është realizuar në 6 stacione dhe 1 stacion në lagunën e Butrintit, kurse monitorimi i cilësisë së ujërave bregdetare të ndikuar nga shkarkimet urbane në 10 stacione në ne qytetet Durrës, Vlorë dhe Sarandë. Monitorimi është realizuar me frekuence 4 herë në vit për ujërat e lumenjve dhe të zonës bregdetare dhe 3 herë në vit për ujërat e liqeneve Monitorimi i cilësisë së ujërave sipërfaqësor është realizuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit. Vlersimi i cilësisë së tyre percaktohet në bazë të parametrave fizikokimikë duke i krahasuar me normat e lejuara të percaktuara në Direktivën Kuadër të Ujit të BE.



**Baseni Ishëm-Erzen** Monitorohet në 10 stacione. Lumi i Ishmit ka 7 stacione monitorimi të vendosura në rrjedhën dhe në degëzimet kryesore të tij. Lumi i Tiranës monitorohet në stacionet Ura e Brarit dhe ura e Kamzës, lumi i Lanës në Lanabregas dhe në ish doganën, lumi i ishmit në urën e Rinasit, Gjolës dhe në urën Salmer në Ishëm. Stacionet e këtij lumi janë nën ndikim të plotë të shkarkimeve urbane dhe industriale të zonës ku kalon ky lum dhe me një presion mjaft të lartë në krahasim me stacionet e tjera të rrjetit të monitorimit të cilësisë së ujërave sipërfaqësore të vendit. Lumi Erzen monitorohet në 3 stacione, Pëllumbas, Ndroq dhe Sallmone

**Grafiket e rezultateve te matjeve te kryera per gjendjen e mjedisit ne disa lumenj te vendit.**










Gjendja: Treguesit NO3 në basenet lumore të Shqipërisë është e larte ose klasa I Trendi: Treguesit NO3 në basenet lumore të Shqipërisë ne vite paraqitet ne vlera te ndryshme brenda basenit, por permbajtja e tyre ne ujerat e lumenjve eshte e ulet ne krahasim me normen e cilesise se mire.



Burimi i informacionit: Raporti i gjendjes se mjedisit per vitin 2014, Ministria e Mjedisit, Agjencia Kombetare e mjedisit(Faqja Zyrtare).

### Njesia e Qeverisjes Vendore

XI.	Tiranë	Qyteti Tiranë			Kashar	Fshatrat; Kashar, Yzberish, Mëzez, Yrshek, Katundi i Ri, Kas, Mazrek
					Pezë	Fshatrat; Pezë e Madhe, Pezë Helmës, Pezë e Vogël, Varosh, Maknor, Dorëz, Gror, Grecë, Pajane, Gjysvilbanë
					Ndroq	Fshatrat; Ndroq, Zbarqe, Keçukje, Zhuqje, Lagje e Re, Pinet, Sauqet, Çalabëzëzë, Slesh, Greblësh, Mënik
					Zall-Herr	Fshatrat; Zall - Herr, Dritas, Çerëze-Morinë, Qanam, Kallmet, Herraj, Pinar, Paskë e Vogël, Radhesh
			Kamëz	Qyteti Kamëz	Kamëz	Qyteti Kamëz, Fshatrat; Bathore, Laknas, Valias, Frutikulturë, Bukesh, Zall-Miner
					Paskuqan	Fshatrat; Paskuqan, Babru Qëndër, Kodër e Kuqe, Shpat, Fushë e Keçukëve, Kodër Babru, Paskuqan Fushë, Paskuqan Kodër
			Vorë	Qyteti Vorë	Vorë	Qyteti Vorë, Fshatrat; Vorë, Marqinet, Shargë, Gërdec, Gjoftaj, Kuc, Manikaj, Picar
					Prezë	Fshatrat; Prezë, Ahmetaj, Palaq, Fushë Prezë, Gjeç- Kodër, Ndërmjetes, Breg - Shkozë
					Bërxullë	Fshatrat; Bërxullë, Muka, Dornje
			Kavajë	Qyteti Kavajë	Kavajë	Qyteti Kavajë
					Synej	Fshatrat; Srnej, Butaq, Rriqaj, Hajdara, Peqinaj, Ruzhull, Bago
					Luz i Vogël	Fshatrat; Luz i Vogël, Vorrozen, Beden, Blerinaj
					Golem	Fshatrat; Golem, Kryemëdhae, Tilaj, Seferaj, Golemas, Qezet, Karpen, Zik-Xhafaj, Kanaparaj, Agonaj, Karpen i Ri
					Helmas	Fshatrat; Helmas, Zikular, Lis-Patros, Sitodhër, Çetë, Momel, Habilaj, Çollakaj, Krvezi, Çikallesh
					Rrogozhinë	Qyteti Rrogozhinë, Fshatrat; Rrogozhinë
			Rrogozhinë	Qyteti Rrogozhinë	Kryevidh	Fshatrat; Kryevidh, Ballaj, Rreth-Greth, Pathë-Milot, Zhubjak, Spanesh, Spalle, Dornë, Stërbeg, Shardushk, Kazie
					Sinaballaj	Fshatrat; Sinaballaj, Methasanaj, Hazdushk, Hameanaj, Koçaj-Sheshaj, Thartor, Rrozej, Fliballinë, Demartaj
					Lekaj	Fshatrat; Lekaj, Harizaj, German, Zambish, Mëshnik, Mlik, Okshtraj, Luz i Madh, Shkozë, Krveuzaj
					Gosë	Fshatrat; Gosë e Madhe, Gosë e Vogël, Kalush, Keçukaj, Vile-Ballaj

## 4. IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE TË MUNDSHME NEGATIVE NË MJEDIS.

### Lloji i ndikimeve të identifikuar (direkte dhe jo direkte)

Vleresimi i ndikimeve ne mjedis kryhet duke u bazuar mbi parimet e mbrojtjes se mjedisit te cilat jane:

- Parimi i zhvillimit të qëndrueshëm
- Parimi i parandalimit dhe marrja e masave paraprake
- Parimi i ruajtjes së burimeve natyrore
- Parimi i zëvendësimit dhe/ose kompensimit
- Parimi i qasjes së integruar
- Parimi i përgjegjësisë së ndërsjellë dhe bashkëpunimit
- Parimi “Ndotësi paguan”
- Parimi i së drejtës për informim dhe i pjesëmarrjes së publikut
- Parimi i nxitjes së veprimtarive për mbrojtjen e mjedisit

Ky vleresim kryhet ne baze te ligjit Nr. 10440, date 07.07.2011 “Per vleresimin e Ndikimit ne Mjedis” dhe ne perputhje me kerkesat e VKM Nr. 686, date 29.07.2015 “Per zhvillimin e procedures se Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis” dhe ka si synim idnetifikimin, vleresimin dhe parandalimin e ndotjes se mjedisit, me qellim mbrojtjen e mjedisit. Me mbrojtje te mjedisit do te kuptojme mbrojtjen e mjedisit nga ndotja e dëmtimi. Kjo përbën përparësi kombëtare dhe është e detyrueshme për çdo banor të Republikës së Shqipërisë, për të gjitha organet shtetërore, si dhe për personat fizikë dhe juridikë, vendas e të huaj, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Objektivat e mbrojtjes së mjedisit janë:

- a) Parandalimi, kontrolli dhe ulja e ndotjes së ujit, ajrit, tokës dhe ndotjeve të tjera
- b) Ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i natyrës dhe i biodiversitetit;
- c) Ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i qëndrueshmërisë mjedisore me pjesëmarrje publike;
- d) Përdorimi i matur dhe racional i natyrës dhe i burimeve të saj;
- e) Ruajtja dhe rehabilitimi i vlerave kulturore dhe estetike të peizazhit natyror;

- f) Mbrojtja dhe përmirësimi i kushteve të mjedisit;
- g) Mbrojtja dhe përmirësimi i cilësisë së jetës dhe shëndetit të njeriut.:

### **Ndikime te rendesishme gjate funksionimit te aktivitetit.**

#### **Shkarkime ne uje**

Ujerrat qe do te dalin nga aktiviteti jane ujera te cilat do te lindin si rrjedhoje e aktivitetit te larjes se materialeve inerte dhe nga kullimi i ujerave te shiut te sheshit te instalimit te impiantit. Ujerrat qe dalin nga aktiviteti i larjes se materialeve inerte jane ujera te turbullt, me perberje te fraksioneve te imeta te tokes, te tilla si rera e imet, lymi dhe argjila. Keto fraksione te imeta te materialit tokesor duke qene te permasave teper te imeta, treten lehtesisht ne uje dhe dekantimi e kullimi i tyre behet me i veshtire e kerkon kohe me te gjate. Keto ujera nese shkarkohen ne mjedisin uxor prites, ndikojne ne demtimin dhe largimin e faunes dhe flores ujore. Efekti i tyre shkakton humbjen e drites diellore nen uje, ul qartesine dhe transparencen e ujit, duke veshtiresuar apo bere te pa mundur te ushqyerit e gjallesave e ne vecanti peshqit, e si rrjedhoje humb ekuilibrin natyror te botes se gjalle e nenujore te ujerave te embla. Per shkarkimin e ujerave te perdorura do te ndertohen dy ose tre vaska dekantuese, e me pas nepermjet nje kanali do te shkarkohen ne mjedisin e zones. Ne sheshin e aktivitetit, nuk do te magazinohen materiale te rrezikshme dhe si rrjedhoje nuk do te kete ndotje te ujerave nentokesore ose siperfaqesore nga keto lende. Mundesite e ndotjes, mund te vijne vetem nga derdhja e hidrokarbureve ose e lubrifikanteve gjate furnizimit te mjeteve te renda te transportit. Ne rast se sheshi i instalimit nuk do te jete i shtruar me beton ose me asfalt, do te hasemi me nje fenomen te filtrimit te ujerave siperfaqesore te rreshjeve ne ujerrat nentokesore. Keto ujera te procesit te larjes se inerteve duhet te kalojne te pakten ne tre vaska dekantuese, ose me shume nese do te kerkohet nje cilesi me e paster uji dhe me shume ne sasi (ne varesi te kapacitetit te kerkuar per uje), para se te rifuten ne procesin e prodhimit, apo te shkarkohen ne burimet ujore te zones. Eshte e rendesishme te theksojme se ne asnje menyre nuk duhet te shkarkohen ne mjedisin e zones direkt pa u trajtuar me pare. Vaskat dekantuese te jene te shtruara me beton dhe te kene nje rend qarkullimi nga njeshi tek treshi e me radhe, duke pasur nje diference te lehte ne kuote e duke qarkulluar uje ne qetesi, ne menyre qe te rritet sedimentimi i grimcave te ngurta te tretura ne uje. Llumi i ketyre vaskave, duhet te menaxhohet ne menyre te "integruar" nga subjekti, jo te hidhet ne mjedisin e zones pa plan menaxhimi. Ai mund te sherbeje per permiresimin e tokes bujqesore, per punime rehabilituese, per mbushje toke, etj.

#### **Emetimet ne ajer**

Emetimet ne ajer nga ky instalim do te vijne kryesisht nga pluhuri i cili mund te ngrihet nga faktoret klimatike nga lenda e pare e magazinuar ose nga llumi i vaskave nese do te depozitohet aty pa plan menaxhimi. Prosesi i larjes dhe bluarjes se materialeve inerte nuk shoqerohet me pluhur, pasi eshte nje proces qe ndodh "ne te njome" dhe me pranine e ujit gjate gjithë kohes, pavaresisht sezonit. Pra pluhurat nga perpunimi, nuk vleresohen ne nivele problematike. Pervец pluhurit te ngritur ne ajer nga era, ne kete ambient, mund te vleresohen edhe gazet qe shkarkohen nga makinerite e ngarkim-shkarkimit dhe nga transportuesit e materialit. Keto jane te pakta ne numer dhe te kolauduara nga Qendra e Kontrollit Teknik te automjetve, pasi ato dalin ne qarkullim ne rruget kryesore e ne qendrat e banuara. Ndersa te gjitha makinerite e tjera si elektromotorre e transportiere, funksionojne nepermjet perdorimit te energjise elektrike dhe jane "te pastra".

Per te shmangur impaktet e ketij aktiviteti nga transporti i materialeve inerte ne rruge e ne qytete, duhet qe kamionet transportues te lahen e pastrohen para daljes ne rruge te asfaltuar si dhe te kene karrocere te mbuluar me mushama te gomuar.

### **Zhurmat dhe vibrimet**

Zhurmat qe prodhohen do te vijne kryesisht nga lavatricja e larjes se materialit inert, bluarjes se materialit inert i cili pasi eshte lare e pastruar nga papastertite, kalon per fraksionim e perpunim sipas permasave te deshiruara. Gjithashtu nje faktor tjetër te prodhimit te zhurmes jane elektromotorret e transportiereve dhe hedhja e kalimi i materialit nga nje pozicion e nje faze ne tjeteren. Nderkohe mjetet rrugore dhe zhurma e prodhuar nga vete personat qe do te punojne per kete aktivitet, nuk vleresohen me potencial ndikues.

Punëtorët që ndodhen në mjedise ku niveli i zhurmave e tejkalon limitin mund dhe duhet të perdorin masa mbrojtese per shqisat e degjimit (Kufje ose tapa per veshet). Ne kete ambjent nuk vleresohen nivele te tilla zhurme qe mund te shkaktojne deri ne shurdhimin e degjimit, por gjithesesi, masat mbrojtese eshte e rekomanduara te perdoren rregullisht. Aktiviteti ndodhet larg qendrave te banuara dhe si rrjedhoje nuk perben shqetesim per banoret persa i perkete pluhurave apo zhurmave. Nuk shkaktohen vibrime.

### **Ndikimi ne toke**

Proceset e punes nuk do te ndikojne ne toke. Ndikime do te kete vetem gjate ndertimit te impiantit, i cili do te zere nje siperfaqe toke bujqesore per instalimin dhe magazinimin e materialeve inerte. Kjo siperfaqe e zene, do te shkaktojte humbjen dhe tjetersimin e nje toke bujqesore e cila eshte e pa rikuperueshme dhe ka nje impakt te pa kthyeshem. Nuk do te demtohet bimesia, nuk do te demtohet relievi as struktura e tokes. Ne rast se sheshi do te jete i pa shtruar me beton, ekziston mundesia e depertimit te ujerave siperfaqesore ne ujerat nentokesore dhe si rrjedhoje ne nje distance te shkurter, mund te ndikohet ne turbullimin e tyre, por jo ne mase te madhe pasi vete efekti i tokes eshte filtrues. Keto ujera qe depertojne nentoke nuk kane perberje te demshme per mjedisin, nuk kane as substanca as elemente kimike te shtuar. Nuk ndikon burimet ujore qe sherbejne per uje te pijshem, keto ujera kane tendencen e shkarkimit te tyre ne shtratin e lumit.

### **Ndikimi ne Biodiversitet**

Kjo zonë nuk bënë pjesë në zonat e ndjeshme te zonave te mbrojtura me ligj, as lloji i aktivitetit nuk ndikon ne biodiversitetin e mjedisit tokesor. Aktiviteti ndodhet ne nje zone te rrethuar nga kultura bujqesore dhe shtrati i Lumi Shkumbin dhe nuk karakterizohet nga specie te egra. Shkarkimi i ujerave te larjes pa u trajtuar, demton ndjeshem biodiversitetin e Lumit Shkumbin, pra sjell deme ne Hidrobiologjine e ketij burimi ujor, madje mund te shtrihet edhe me tej deri ne grykederdhjen e lumit. Ndaj rekomandojme patjeter trajtimin e ujerave para shkarkimit te tyre.

### **Ndikimi ne Mjedisin Social**

Ndikimi i ketij projekti ne mjedisin social, do te jete pozitiv persa i perkete punesimit, sherbimit te shitjes se materialeve inerte per ndertim, konkurrences ne treg dhe uljes se cmimeve nga shitja direkt nga pika e shumices, etj. Efekti negativ i vetem eshte ne rastet e shkarkimit te ujerave ne lumin Shkumbin dhe demtimin e peshqve e zinxhirit ushqimor te tyre. Por jo vetem demtim te faunes ujore, por uljen e cilesise se ujit te lumit i cili mund te perdoret edhe per plazh e rekreacion nga banore te zones e me tej. Per te shmangur keto

efekte, subjekti duhet të jetë pajisur me vaska dekantuese dhe sistem tepër efektiv e të disponueshëm për të dekantuar ujë dhe për të riqarkulluar të njëjtin ujë në sistemin e larjes së materialeve. Objekti nuk duhet të funksionojë në një zonë të rrezikuar nga permbytjet, të rrezikuar nga zjarret (sic janë pyjet), nuk duhet të ketë akses askush i paautorizuar dhe duhet të ketë siguri fizike.

### **Mbetjet e prodhuara**

Mbetje të ngurta që do të prodhohen janë ato urbane nga aktiviteti human, por edhe llumi i argjilës së vaskës dekantuese dhe të shesheve të depozitimit. Nuk vlerësohet aktiviteti me prodhim të mbetjeve të ngurta të rrezikshme, pasi materiali është 100% i përdorshëm për qëllime të tjera dhe nuk është toksik për mjedisin. Llumi i vaskave dekantuese, kërkon trajtim të integruar dhe përdorim të tij në zonë ku nuk demtohet mjedisi biologjik, ujor dhe ai i tokave bujqësore, ai nuk mund të hidhet në mjedise të çfarëdo lloji dhe pa një miratim të autoriteteve përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit dhe të tokës bujqësore.

## **5. PËRSHKRIM I SHKARKIMEVE TË MUNDSHME NË MJEDIS.**

Informacion për shkarkimet në mjedis.

Ujërë që do të dalin nga aktiviteti janë ujëra të cilat do të lindin si rrjedhojë e aktivitetit të larjes së materialeve inerte dhe nga kullimi i ujërave të shiut të sheshit të instalimit të impiantit. Ujërë që dalin nga aktiviteti i larjes së materialeve inerte janë ujëra të turbullt, me përberje të fraksioneve të imeta të tokës, të tilla si rëra e imet, lymë dhe argjila. Këto fraksione të imeta të materialit tokësor duke qenë të permasave tepër të imeta, treten lehtësisht në ujë dhe dekantimi e kullimi i tyre bëhet më i vështirë e kërkon kohë më të gjatë. Këto ujëra nëse shkarkohen në mjedisin ujor priten, ndikojnë në demtimin dhe largimin e faunës dhe flores ujore. Efekti i tyre shkakton humbjen e dritës diellore nën ujë, ul qartësinë dhe transparencën e ujit, duke vështirësuar apo bërë të pamundur të ushqyerit e gjallesave e në vecanti peshqit, e si rrjedhojë humb ekuilibrin natyror të botes së gjallë e nënujore të ujërave të embla. Për shkarkimin e ujërave të përdorura do të ndërtohen dy ose tre vaska dekantuese, e me pas nëpërmjet një kanali do të shkarkohen në mjedisin e zonës. Në sheshin e aktivitetit, nuk do të magazinohen materiale të rrezikshme dhe si rrjedhojë nuk do të ketë ndotje të ujërave nëntokësore ose sipërfaqësore nga këto lende. Mundësitë e ndotjes, mund të vijnë vetëm nga derdhja e hidrokarbureve ose e lubrifikanteve gjatë furnizimit të mjeteve të rëndësishme të transportit. Në rast se sheshi i instalimit nuk do të jetë i shtruar me beton ose me asfalt, do të hasemi me një fenomen të filtrimit të ujërave sipërfaqësore të rrëshjeve në ujërë nëntokësore. Këto ujëra të procesit të larjes së inerteve duhet të kalojnë të pakten në tre vaska dekantuese, ose me shumë nëse do të kërkohej një cilësi më e pastër uji dhe me shumë në sasi (në varësi të kapacitetit të kërkuar për ujë), para se të rifuten në procesin e prodhimit, apo të shkarkohen në burimet ujore të zonës. Është e rëndësishme të theksojmë se në asnjë mënyrë nuk duhet të shkarkohen në mjedisin e zonës direkt pa u trajtuar më parë. Vaskat dekantuese të jenë të shtruara me beton dhe të kenë një rëndë qarkullimi nga njëshi tek treshi e më radhe, duke pasur një diferencë të lehtë në kuotë e duke qarkulluar ujë në qetësi, në mënyrë që të rritet sedimentimi i grimcave të ngurta të tretura në ujë. Llumi i këtyre vaskave, duhet të menaxhohet në mënyrë të "integruar" nga subjekti, jo të hidhet në mjedisin e zonës pa plan menaxhimi. Ai mund të shërbejë për përmirësimin e tokës bujqësore, për punime rehabilituese, për mbushje toke, etj.

Emetimet ne ajer nga ky instalim do te vijne kryesisht nga pluhuri i cili mund te ngrihet nga faktoret klimatike nga lenda e pare e magazinuar ose nga llumi i vaskave nese do te depozitohet aty pa plan menaxhimi. Procesi i larjes dhe bluarjes se materialeve inerte nuk shoqerohet me pluhur, pasi eshte nje proces qe ndodh "ne te njome" dhe me pranine e ujit gjate gjithe kohes, pavaresisht sezonit. Pra pluhurat nga perpunimi, nuk vleresohen ne nivele problematike. Perverc pluhurit te ngritur ne ajer nga era, ne kete ambjent, mund te vleresohen edhe gazet qe shkarkohen nga makinerite e ngarkim-shkarkimit dhe nga transportuesit e materialit. Keto jane te pakta ne numer dhe te kolauduara nga Qendra e Kontrollit Teknik te automjetve, pasi ato dalin ne qarkullim ne rruget kryesore e ne qendrat e banuara. Ndersa te gjitha makinerite e tjera si elektromotorre e transportiere, funksionojne nepermjet perdorimit te energjise elektrike dhe jane "te pastra".

Per te shmangur impaktet e ketij aktiviteti nga transporti i materialeve inerte ne rruge e ne qytete, duhet qe kamionet transportues te lahen e pastrohen para daljes ne rruge te asfaltuar si dhe te kene karrocetine te mbuluar me mushama te gomuar.

Zhurmat qe prodhohen do te vijne kryesisht nga lavatricja e larjes se materialit inert, bluarjes se materialit inert i cili pasi eshte lare e pastruar nga papastertite, kalon per fraksionim e perpunim sipas permasave te deshuruara. Gjithashtu nje faktor tjeter te prodhimit te zhurmes jane elektromotorret e transportiereve dhe hedhja e kalimi i materialit nga nje pozicion e nje faze ne tjeteren. Nderkohe mjetet rrugore dhe zhurma e prodhuar nga vete personat qe do te punojne per kete aktivitet, nuk vleresohen me potencial ndikues.

Punëtorët që ndodhen në mjedise ku niveli i zhurmave e tejkalon limitin mund dhe duhet të perdorin masa mbrojtese per shqisat e degjimit (Kufje ose tapa per veshet). Ne kete ambjent nuk vleresohen nivele te tilla zhurme qe mund te shkaktojne deri ne shurdhimin e degjimit, por gjithesesi, masat mbrojtese eshte e rekomanduara te perdoren rregullisht. Aktiviteti ndodhet larg qendrave te banuara dhe si rrjedhoje nuk perben shqetesim per banoret persa i perkete pluhurave apo zhurmave. Nuk shkaktohen vibrime.

Proceset e punes nuk do te ndikojne ne toke. Ndikime do te kete vetem gjate ndertimit te impiantit, i cili do te zere nje siperfaqe toke bujqesore per instalimin dhe magazinimin e materialeve inerte. Kjo siperfaqe e zene, do te shkaktoje humbjen dhe tjetersimin e nje toke bujqesore e cila eshte e pa rikuperueshme dhe ka nje impakt te pa kthyeshem. Nuk do te demtohet bimesia, nuk do te demtohet relievi as struktura e tokes. Ne rast se sheshi do te jete i pa shtruar me beton, ekziston mundesia e depertimit te ujerave siperfaqesore ne ujerat nentokesore dhe si rrjedhoje ne nje distance te shkurter, mund te ndikohet ne turbullimin e tyre, por jo ne mase te madhe pasi vete efekti i tokes eshte filtrues. Keto ujera qe depertojne nentoke nuk kane perberje te demshme per mjedisin, nuk kane as substanca as elemente kimike te shtuar. Nuk ndikon burimet ujore qe sherbejne per uje te pijshem, keto ujera kane tendencen e shkarkimit te tyre ne shtratin e lumit.

Mbetje te ngurta qe do te prodhohen jene ato urbane nga aktiviteti human, por edhe llumi i argjiles se vaskes dekantuese dhe te shesheve te depozitimit. Nuk vleresohet aktivitet me prodhim te mbetjeve te ngurta te rrezikshme, pasi materiali eshte 100% i perdorshem per qellime te tjera dhe nuk eshte toksik per mjedisin. Llumi i vaskave dekantuese, kerkon trajtim te integruar dhe perdorim te tij ne zona ku nuk demtohet mjedisi biologjik, ujqor dhe ai i tokave bujqesore, ai nuk mund te hidhet ne mjedise cfaredo lloji dhe pa nje miratim te autoriteteve pergjegjese per mbrojtjen e mjedisit dhe te tokes bujqesore.

uje te pijshem, keto ujera kane tendencen e shkarkimit te tyre ne shtratin e lumit.

## **6. INFORMACIONI PËR KOHËZGJATJEN E MUNDSHME TË NDIKIMEVE NEGATIVE.**

Ndikimi i aktivitetit ne kushte normale funksionimi do te zgjase per aq kohe sa zgjat edhe aktiviteti. Ndikimi ne mjedis do te zgjase per aq ore sa do te funksionoje aktiviteti ne dite dhe aq dite sa ai do te funksionoje ne nje vit.

## **7. SHTRIRJA HAPËSINORE E NDIKIMIT NEGATIV NË MJEDISIN E ZONËS.**

Ndikimi ne mjedisin e zones ne kushte normale te punes, mund te perhapet ne nje distance fare te ngushte, me dhjetera metra, ose deri ne 200m, kjo persa i perkete ndikimit te zhurmes, pasi ndikimi ne ujera nese do te shkarkohen ne mjediset ujore mbi vlerat e lejuara, do te shtrinte ndikimin e tij deri ne disa km, ose dhjetra km. Ujerat e gjeneruar nga aktiviteti nuk kane ndotje kimike, por vetem turbulliren me lenden e fraksioneve te imeta te argjiles, lymit dhe reres se imet, te cilat dalin nga procesi i larjes se materialeve inerte. Nuk shkarkohen substanca ose elemente te demshem per mjedisin, si ne ate uhor, per ajrin, token dhe per biodiversitetin. Nuk ka procese me perdorimin e substancave te demshme. Per parandalimin e ketyre efekteve, subjekti duhet te zbatoje me rigorozitet kushtet teknike. Duhet te kontrolloje dhe mirembaje vaskat dekantuese te shkarkimit te ujerave.

## **8. REHABILITIMI I MJEDISIT TË NDIKUAR DHE MUNDËSIA E KTHIMIT TË TIJ NË GJENDJEN E MËPARSHME.**

Subjekti investitor, duhet te kujdeset per nje mjedis te paster, te rregullt, te gjelberuar, te sigurte dhe te pajisur me sinjalistiken dhe posterat sensibilizues perkates per kushtet teknike dhe per mjedisin. Mjedisi i ketij aktiviteti eshte me funksion si impiant per larjen e inerteve lumore. Ne rast te mbylljes se aktivitetit, mund te merret ne konsiderate mundesia e rehabilitimit te plote te siperfaqeve dhe kthimin e peizazhit ne gjendjen e mepareshme. Per kete, subjekti duhet te hartoje nje plan mbyllje te aktivitetit, qe duke u nisur nga strukturat e perkohshme, nuk paraqitet me kosto shume te larta. Vlerat e tokes bujqesore jane te pa kthyeshme, por rehabilitimi i siperfaqes, mund te pasohet me punime pleherimi e pasurimi te tokes, duke krijuar mundesine e mbjelljes se bimesise dhe pyllezimit te zones.

## **9. MASAT E MUNDSHME PËR SHMANGIEN DHE ZBUTJEN E NDIKIMEVE NEGATIVE NË MJEDIS.**

Ne menyre te pergjithshme do te japim disa prej masave qe duhet te zbatohen nga investitori per mbarefunksionimin e aktivitetit dhe ruajtjen e mjedisit fizik e biologjik.

- Duhet te punohet sipas rregullores se kushteve teknike, nuk duhet te lejohen derdhje te karburanteve dhe lendeve te tjera djegese ne mjedisin e aktivitetit, pasi ndotin ambjentin dhe mund te jene burim aksidenti e shkaktar te zjarreve te pa deshiruara e me tej mund te shkaktoje edhe shperthime.
- Ne sheshin e aktivitetit, nuk duhet te magazinohen materiale te rrezikshme.
- Mjetet rrugore qe qarkullojne duhet te jene konform normave te percaktuara dhe te testuara nga Qendra e Kontrollit Teknik te automjeteve e te pajisura me certifikaten perkatese.
- Punëtorët që ndodhen në mjedise ku niveli i zhurmave e tejkalon limitin duhet të perdorin masa mbrojtese per shqisat e degjimit (Kufje ose tapa per veshet).

- Te rehabilitohet sipërfaqja përreth objektit, duke u gjelberuar dhe duke krijuar një efekt ndihmes në reduktimin e zhurmës dhe të pluhurit.
- Te shtrohet me asfaltobeton sheshi i qarkullimit të automjeteve me qëllim shmangien e pluhurave dhe depertimin e ujerave sipërfaqësore në toke.
- Te ndërtohen vaskat e dekantimit të ujerave të largjes së inerteve dhe të ndërtohet cikël i mbyllur riqarkullues i ujit të përdorur.
- Subjekti të mos shfrytëzojë burimet ujore apo ato tokësore të zonës pa pasur miratimin e autoriteteve përkatëse me pare.
- Të mirëmbahet sheshi i depozitimit, duke mos lejuar erozionin dhe shpërthimin e materialit për në burimin ujor të lumit Shkumbin.
- Mjetet e transportit të lahen dhe pastrohen mirë para daljes në rruget e asfaltuara të zonës.
- Mjetet e transportit të inerteve, gjatë qarkullimit duhet që të kenë të mbuluar karrocet me mushama të gomuarë për të mbrojtur dhe frenuar përhapjen e materialit nëpër rruget e asfaltuara dhe si rrjedhojë edhe shmangien e ndotjes e të aksidenteve në rrugë.


## **10. NDIKIMET E MUNDSHME NË MJEDISIN NDËRKUFITAR (NËSE PROJEKTI KA NATYRË TË TILLË).**

Ky projekt nuk prek zonat kufitare dhe si rrjedhojë edhe ndikimi i tij nuk shkakton dëm të mjedisit nderkufitar. Projekti nuk ndikon në cenimin e sigurisë së jetës dhe shëndetit të shteteve fqinje, madje në kushte normale, as të qendrave të banuara të rajonit. Nuk ndikohen burimet ujore nderkufitare, nuk ndikohet cilesia e ajrit në kontekstin nderkufitar. Për këtë kapitull, nuk kryhen vlerësime dhe analiza të detajuara për shkak të vendodhjes së projektit në brendësi të kufirit shtetëror dhe distancës që ai ruan me kufirin dhe shtet fqinje.



**ANEKS:**

**Harta topografike e rajonit. Nomenclatura e Hartes ne shkalle 1:2500 (K-34-100-(196-C))**



Koordinatat e objektit ne sistemin Gaus-Kruge		
Nr.	Koordinatat Y	Koordinatat X
1	4382928.92	4549063.47
2	4382994.49	4548845.04
3	4383074.69	4548924.64